

L I G J
Nr.8685, datë 9.11.2000

PËR NJË TRAJTIM TË VEÇANTË TË PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË MINIERA NË NËNTOKË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Me termin bazë e vlerësuar do të kuptohet paga sipas së cilës janë derdhur kontributet për sigurimet shoqërore nga data 1.1.1994 e deri në çastin e lindjes së të drejtës për përfitim.

Me termin përfitim minimal do të kuptohet masa mujore e përfitimit të caktuar në nivelin minimal, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Me termin periudhë sigurimi do të kuptohen të gjitha periudhat e marrëdhënieve të punës për të cilat janë derdhur kontributet për sigurimet shoqërore.

Me termin veprimtari ekonomike do të kuptohet ushtrimi i çdo lloj veprimtarie në të cilën personat janë në marrëdhënie si të punësuar ose të vetëpunësuar, me përjashtim të atyre personave të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike si të vetëpunësuar në bujqësi.

Neni 2

Punonjësit që kanë punuar në miniera për një periudhë jo më pak se 11 vjet e gjysmë në nëntokë dhe kanë një periudhë sigurimi jo më pak se 23 vjet, në rastet kur nuk ushtrojnë veprimtari ekonomike, trajtohen me përfitim.

Neni 3

Masa e përfitimit për këta punonjës do të jetë e barabartë me 60 për qind të bazës së vlerësuar. Në rastet kur për llogaritjen e bazës së vlerësuar mungojnë dokumentet, masa e përfitimit do të caktohet në nivelin e përfitimit minimal, i cili përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4

E drejta e ushtrimit të kërkesës për përfitime nga ky ligj mund të ushtrohet nga subjektet që përfitojnë deri më datë 31.3.2001. Kjo kërkesë paraqitet pranë degëve të agjencive të drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore.

Neni 5

Përjashtohen nga përfitimet, sipas këtij ligji, personat të cilët përfitojnë të ardhura nga skema e sigurimeve shoqërore.

Neni 6

Përfitimet nga ky ligj financohen nga Buxheti i Shtetit, ndërkohë detyrimet e prapambetura nga ndërmarrjet minerare ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore nuk përbëjnë pengesë për këtë përfitim. Llogaritja, caktimi dhe pagimi i përfitimeve që rrjedhin nga ky ligj bëhen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, kundrejt një pagese komisioni e cila përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave nxjerr aktet përkatëse nënligjore në përputhje me këtë ligj.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I
Skënder Gjinushi

Shpallur me dekretin nr.2800, date 20.11.2000 te Presidentit te Republikës se Shqipërisë Rexhep Meidani
